

Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall vendin vakant për Përgjegjës në Sektorin e Prokurimeve, në Drejtorinë e Shërbimeve, Blerjeve dhe Investimeve pranë Rektoratit, si më poshtë:

Kriteret për kandidim janë:

Kritere të veçanta që duhet të plotësojë kandidati për Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve.

- a) Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Ekonomike/Juridike ose Shkenca Inxhinierike.
- b) Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e prokurimeve.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve.

- c) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- d) Të jete në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- e) Të mos jetë denuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
- f) Ndaj tij të mos jetë marrë ndonjë masë disiplinore për largimin nga detyra.

DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **10.12.2020** pranë Zyrës së Protokollit në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Curriculum Vitae;
3. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuar. (Aplikantët që kane kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
4. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
5. Kopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Certificate kualifikimi dhe trajnimesh të ndryshme (ne rast se ka);
7. Raport mjekësor për aftësi në punë;
8. Dëshmi penaliteti ose formular vetëdeklarimi.